



QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
NATIONAL BUSINESS CENTER


Bashkëpunimi Ligjor i QKB me Institucionet

dhe

Administrimi i të Dhënave të Biznesit



WWW.QKB.GOV.AL





Bashkëpunimi ligjor i QKB me Institucionet e tjera

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), si institucion publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, ka përgjegjësinë për administrimin e Regjistrit Tregtar Kombëtar dhe ofrimin e shërbimeve të integruara për subjektet ekonomike. Në përmbushje të këtij funksioni, QKB zhvillon ndërveprime ligjore me një sërë institucionesh, përfshirë:

- Institucionet e sistemit të drejtësisë (SPAK, Prokuroria, Gjykatat);
- Ministritë dhe agjencitë Qendrore;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe pushtetin lokal.

Ndërveprimi me Institucionet e Drejtësisë (SPAK, Prokuroria, Gjykatat)

Qëllimi:

Sigurimi i informacionit dhe dokumentacionit të besueshëm për proceset gjyqësore dhe hetimet penale.

FORMAT E NDËRVEPRIMIT:

- DORËZIMI I TË DHËNAVE PËR SUBJEKTET TREGTARE
(STATUTE, EKSTRAKTE, VENDIME)
- ZBATIMI I URDHËRAVE GJYQËSORË PËR:
 - PEZULLIM TË REGJISTRIMEVE
 - SHËNIME MBI MASA SIGURIE PASURORE
 - BLLOKIM APO KONFISKIM TË VEPRIMEVE LIGJORE
- VERIFIKIMI I STATUSIT LIGJOR TË BIZNESEVE PËR
QËLLIME HETIMORE

Ndërveprimi me Ministritë dhe Agjencitë Qendrore

Qëllimi:

Mundësimi i qasjes në të dhëna të sakta për politika ekonomike, kontroll administrativ dhe vendimmarrje.

FORMAT E NDËRVEPRIMIT:

- KOORDINIM PËR LICENCIM DHE AUTORIZIME
- SHKËMBIM ELEKTRONIK I TË DHËNAVE PËRMES PLATFORMAVE TË INTEGRUARA (E-ALBANIA, REGJISTRI QENDROR)
- BASHKËPUNIM PËR LEGALIZIMIN E BIZNESEVE NËPËRMJET FUSHATAVE TË PËRBASHKËTA
- DHËNIA E TË DHËNAVE STATISTIKORE PËR:
 - MINISTRINË E FINANCAVE
 - MINISTRINË E EKONOMISË
 - INSTAT
 - DREJTORINË E TATIMEVE
- MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR RAPORTIMIN E PRONARËVE PËRFITUES (ME DPPPP)

Ndërveprimi me Pushtetin Vendor

Qëllimi:

Koordinimi për licencim lokal, inspektime, taksim dhe formalizim të ekonomisë vendore.

FORMAT E NDËRVEPRIMIT:

- QASJE E BASHKIVE NË TË DHËNAT E REGJISTRIT
TREGTAR
- BASHKËPUNIM PËR SHËRBIME TË LËVIZSHME DHE
FUSHATA NDËRGJEGJËSIMI
- VERIFIKIM LEJESH PËR VEPRIMTARI TREGTARE
- RAPORTIM PËR SUBJEKTET QË OPEROJNË NË NIVEL
LOKAL

Roli i QKB në Transparencë dhe Kontroll Ligjor

QKB vepron si:

- Garantues i të dhënave ligjore të bizneseve
- Ndërfaqe ndërinstytucionale për shkëmbim informacioni
- Mjet kyç për hetime ekonomike dhe zbatimin e ligjit

Përfundime

Ndërveprimi ligjor i QKB me institucionet e treta synon:

- Forcimin e sundimit të ligjit
- Rritjen e transparencës në ekonomi
- Përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstytucional

QKB mbetet një aktor kyç në sistemin e qeverisjes dhe drejtësisë në Shqipëri, duke kontribuar në një mjedis biznesi më të sigurt dhe të formalizuar.

Statistika dhe të Dhëna
për Biznesin në Shqipëri:

Roli i QKB-së në
Përpunimin dhe
Përdorimin e të Dhënave
të Regjistrit Tregtar



Në një ekonomi moderne, të dhënat janë një nga burimet më të rëndësishme për marrjen e vendimeve të informuara, hartimin e politikave publike dhe zhvillimin e strategjive ekonomike. Në këtë kontekst, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ka një rol të qenësishëm në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore mbi biznesin në Shqipëri, përmes menaxhimit të Regjistrit Tregtar Kombëtar.

Të dhënat e biznesit nuk janë thjesht numra, ato janë një pasqyrë reale e gjendjes dhe e potencialit ekonomik të vendit. Përmes menaxhimit profesional të Regjistrit Tregtar dhe publikimit të raporteve statistikore, QKB kontribuon në një ekonomi më transparente, të bazuar në të dhëna dhe më të aksesueshme për çdo aktor të interesuar.

SI I PËRDOR QKB TË DHËNAT E REGJISTRIT TREGTAR?

QKB funksionon si një pikë e vetme për regjistrimin, ndryshimin dhe çregjistrimin e subjekteve tregtare në Shqipëri.



Të dhënat e regjistrit përdoren për:

- Menaxhim të saktë të informacionit për subjektet tregtare, duke siguruar që të gjitha të dhënat ligjore dhe administrative të jenë të përditësuara.
- Përmirësimin e shërbimeve ndaj bizneseve, duke thjeshtuar proceset dhe reduktuar kohën për procedurat ligjore.
- Ofrimin e transparencës në proceset administrative, duke u mundësuar institucioneve publike, bizneseve dhe publikut të gjerë akses në informacionin zyrtar mbi subjektet tregtare.
- Mbështetje për vendimmarrje nga institucionet shtetërore dhe bizneset përmes të dhënave të besueshme.
- Sigurimin e integritetit të tregut, duke ndihmuar në parandalimin e abuzimeve dhe rritjen e besimit mes palëve tregtare.

Procesi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave

FAZA	BURIMI	QËLLIMI
Regjistrimi fillestar	Aplikimi i biznesit	Krijimi i dosjes
Përditësimi i të dhënave	Deklarimet e biznesit	Reflektimi i ndryshimeve
Verifikimi & kontrolli	Dokumente zyrtare	Ligjshmëri dhe saktësi
Publikimi	Regjistri elektronik	Transparencë publike
Shkëmbimi i të dhënave	Institucione shtetërore	Koordinim institucional
Analiza & raportimi	Të dhëna të grumbulluara	Statistika & politika
Arkivimi / çregjistrimi	Dosja elektronike	Ruajtje historike



Llojet e të dhënave të menaxhuara nga QKB





1. TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË SUBJEKTIT

- Emri tregtar / Firma
- Numri unik i identifikimit (NIPT)
- Forma ligjore (sh.p.k, sh.a, etj.)
- Data e regjistrimit

2. TË DHËNAT E THEMELUESVE DHE ADMINISTRATORËVE

- Emri, mbiemri dhe të dhëna identifikuese të aksionarëve / ortakëve
- Të dhënat e administratorit, përfaqësuesit ligjor ose bordit drejtues

3. TË DHËNAT MBI KAPITALIN DHE PRONËSINË

- Kapitali themeltar dhe ndryshimet e tij
- Përqindja e pjesëmarrjes së ortakëve/aksionarëve
- Transferimi i kuotave apo aksioneve



4. TË DHËNAT MBI ADRESËN DHE VEPRIMTARINË

- Adresa e selisë qendrore
- Degët, filiale apo përfaqësitë
- Objekt i veprimtarisë ekonomike

5. TË DHËNAT MBI STATUSIN LIGJOR

- Aktiv, pezulluar apo i çregjistruar
- Vendimet gjyqësore që ndikojnë statusin
- Proceset e falimentimit ose likuidimit

6. TË DHËNA HISTORIKE

- Ndryshimet e bëra në statut, kapital, drejtues, adresë etj.
- Historiku i regjistrimeve dhe çregjistrimeve

7. TË DHËNAT E DOKUMENTEVE ZYRTARE

- Akti i themelimit dhe statuti
 - Vendime të asamblesë / bordit
 - Kontrata apo dokumente të tjera të depozituara
- 

QKB dhe regjistrat në varësi të saj



QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit)

Institucioni kryesor që menaxhon regjistrat kombëtarë të bizneseve.
Administron regjistrat e mëposhtëm:

RT

Regjistri Tregtar – përfshin bizneset, dokumentet ligjore, statusin dhe ndryshimet.

- Menaxhon të dhënat mbi licencat, autorizimet dhe lejet e subjekteve.
- Regjistron vendimet për dhënie, rinovim ose heqje licence.
- Siguron kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive të licencuara.

RLLA


Regjistri i Licencave – menaxhon licencat dhe autorizimet e subjekteve.

- Menaxhon të dhënat mbi licencat, autorizimet dhe lejet e subjekteve.
- Regjistron vendimet për dhënie, rinovim ose heqje licence.
- Siguron kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive të licencuara.

RPP

Regjistri i Pronareve Përfitues – përmban të dhënat mbi pronarët përfitues realë.

- Përmban të dhëna mbi pronarët përfitues realë të subjekteve.
- Tregon përqindjen e zotërimit dhe mënyrën e kontrollit.
- Ndihmon për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.



KARAKTERISTIKAT KRYESORE TE SISTEMIT TE QKB

- Përditësime në kohë reale
- Akses nëpërmjet portaleve web, API open Data ,
raporteve të publikuara
- Kategorizim i thjeshtë- filtrim sipas sektorit, rajonit
apo llojit ligjor
- Mbrojtje e privatësisë

OKB